



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1 Tubimi në Tiranë/ Protesta ndahet në dy grupime, thellohet përçarja mes të pranishmëve! Bllokohet qarkullimi i mjeteve në kryqëzimin e urës së Lanës (VIDEO)
- 2 Protestuesit në bulevard përçahen, Balla i përsëritet nga Paskuqani pas dëgjësës me banorët
- 3 Daton prej 98 vjetësh, OpenAI zgjidh një nga Problemat e Mijëvjeçarit' në matematikë brenda 88 orëve
- 4 Pas vilës në Dhërmë, SPAK i sekuestron një tjetër në Palasë, sërish në emër të llogaritësit
- 5 Tares! Balluku nën hetim për shkelje të barazisë në tendera të Unaza, korrupsion, mosdeklarim pasurie e pastrim parash
- 6 I arrestuari dëmtoi kamerën, tavanin dhe orndritë në komisaratin e Sarandës, pezullohen 3 efektive

Kronikë

Plagosi 29-vjeçarin në këmbë pas konfliktit në Krumë, vetëdorëzohet i dyshuari! Shkon në polici me pistoletën, i gjendet edhe kallashnikov e antiplumb

30 vjeçari, ishte shpallur në kërkim pas plagosjes së një personi një ditë më parë. Pas negociatave me familjarët u vetëdorëzua në Policinë e Kukësit, ndërsa gjatë kontrolleve iu gjetën edhe armë e municione.



Redaksia 9 Shtator, 13:39 | Përditësimi: 9 Shtator, 13:42



Një ditë pasi dyshohet se qëllloi me armë zjarri një 29-vjeçar në Krumë dhe u largua nga vendngjarja, F.D., rreth 30 vjeç, është vetëdorëzuar në Policinë e Kukësit. Ai është paraqitur së bashku me pistoletën që dyshohet se përdori gjatë plagosjes, ndërsa gjatë kontrolleve policia i ka gjetur edhe një kallashnikov, antiplumb, dylibi dhe municion luftarak.

Ngjarja për të cilën akuzohet 30-vjeçari ndodhi pasditen e 8 shtatorit, rreth orës 17:10, në vendin e quajtur "Kryqezi i Spitalit", në qytetin e Krumës.

Sipas policisë, F.D. dhe 29-vjeçari me inicialet J.A., të dy banues në Krumë, janë përfshirë në një konflikt për motive të dobëta. Gjatë konfliktit, 30-vjeçari dyshohet se ka përdorur armën, duke qëlluar J.A. në këmbë.

LEXO EDHE: Punonjësi i bashkisë në Tropojë ndërroi jetë pasi e zuri korrenti, arrestohet drejtori i shërbimeve publike dhe drejtuesi teknik i punimeve (EMRAT)

Pas të shtënave, i dyshuari është larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa 29-vjeçari i plagosur ka marrë ndihmë mjekësore. Policia njofton se ai ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Menjëherë pas ngjarjes, F.D. u shpall në kërkim dhe shërbimet e policisë nisën punën për kapjen e tij.

Kërkimet vijuan deri sot, kur, sipas DVP Kukës, pas negociatave me familjarët, 30-vjeçari vendosi të vetëdorëzohej.

F.D. u paraqit në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës së bashku me një pistoletë, e cila dyshohet se është arma e përdorur për plagosjen e 29-vjeçarit. Pistoleta është sekuestruar si provë materiale.

Por gjatë kontrolleve të mëtejshme në automjetin dhe banesën e 30-vjeçarit, policia gjeti edhe sende të tjera. Konkretisht, u sekuestruan një armë zjarri kallashnikov, një dylibi, një antiplumb dhe municion luftarak.

Pas vetëdorëzimit, specialistët e Sektorit për Krimet e Rënda në DVP Kukës, në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Has, arrestuan F.D.

Ai akuzohet për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake".

Hetimet për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes vijojnë nën drejtimin e Prokurorisë.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D/Shqiptarja.com TAG: krume, Kukes, Has, arme zjarri

Sa e vlerësoni këtë artikull? LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Ngërçi për pagat e drejtësisë, kujt i jepni të drejtë? 7 Shtator, 07:56


Qeverisë Magjistratëve Nuk e di

Lajme të tjera

- Has/ Plagosje me armë zjarri në Krumë, në kërkim autori 8 Shtator, 14:47
- Po vendosnin ndriçimin e rrugës në Tropojë, 4 punonjësit e Bashkisë i kap korenti! Ndërron jetë 59 vjeçari, tre të tjerë në spital (EMRAT) Benet Beqiri 8 Shtator, 13:10
- Hyri me armë zjarri brenda një studioje muzikore në Kosovë dhe kërcënoi pronarin, Gjesti i shpëton burgut! Dënohet 2 vite me kusht dhe 6 mijë euro gjobë 7 Shtator, 16:28
- Zjarr në Borje të Kukësit, era favorizon flakët 6 Shtator, 14:29
- Vespat 'pushtojnë Prishtinën', nis festivali ndërkombëtar! 50 prej tyre nga Shqipëria (VIDEO) Benet Beqiri 5 Shtator, 16:15
- 'Një nga ne'/ Njihuni me dy kultivuesit e mjedrave në Kukës: Janë fitimprurëse, por kanë shumë sfida! Ja çmimi në treg Xhensila Nako 5 Shtator, 15:17
- Fundjava sjell fluks në Morinë, mbi 15 mijë qytetarë të Kosovës hyjnë në Shqipëri në 4 orë (VIDEO) Benet Beqiri 5 Shtator, 10:53
- I riu nga Kukësi ekstradohet Dubai, kërkohej për dhunë në familje dhe armëmbajtje pa leje (VIDEO) 5 Shtator, 10:00
- Lorenc Vangjeli: Kur biznesi përdor armët, çfarë ndodh me ata që shkuan nga armët në biznese Lorenc Vangjeli 4 Shtator, 20:09
- Qëllloi me pistoletë në ajër pas një konfliktit, pranga 53-vjeçarit në Himarë (VIDEO) 4 Shtator, 13:50
- Po udhëtonte drejt Anglisë me gruan dhe 4 fëmijët e mitur, kapet në Rinas me pistoletë në bagazh, arrestohet 42-vjeçari: Harrova që e kisha në çantë! (EMRI) 2 Shtator, 14:22
- Me pistoletë në makinë tre të arrestuar në Fier! Tentuan të largoheshin pasi panë policinë (VIDEO) 2 Shtator, 12:50




Lajmi i fundit Daton prej 98 vjetësh, OpenAI zgjidh një nga 'Problemat e Mijëvjeçarit' në matematikë brenda 88 orëve 9 Shtator, 21:44





RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



×

Sh

.com

Lajmi i fundit

Daton prej 98 vjetësh, OpenAI zgjidh një nga ‘Problemat e Mijëvjeçarit’ në matematikë brenda 88 orëve

9 Shtator, 21:44